

Vendimi Nr.101, date 26.08.2008**PERMBAJTJA****KAPITULLI I – PARATHENIE**

- I.1 Hyrje**
- I.2 Shpjegime**

KAPITULLI II – KERKESA TE PERGJITESHME

- II.1 Qellimi**
- II.2 Objekti**
- II.3 Kërkesa te Pergjitheshme te Paisjeve te Matjes**
- II.4 Verifikimi i Egzistences se Certifikimit dhe Testimit te Sistemit te Matjes**
- II.5 Pjesemarresit e Tregut**
- II.6 Kerkesat per Matesat dhe Regjistrimi**
- II.7 Menaxhimi i te Dhenave te Matjes**
- II.8 Mbrojtja nga Nderhyrjet dhe Demtimet**
- II.9 Kerkesat per Perdoruesit dhe Konsumatorët Fundore**
- II.10 Perberja e Komisionit te Kodit te Matjes**
- II.11 Funkcionet e Komisionit te Kodit te Matjes (KKM)**
- II.12 Informacioni**
- II.13 Njoftimet**

KAPITULLI III – KERKESAT TEKNIKE

- III.1 Hyrje**
- III.2 Referencat**
- III.3 Pikat e Matjes**
- III.4 Standartet e Paisjeve te Matjes**
- III.5 Saktësia dhe Kufijet e Gabimit te Sistemit te Matjes**
- III.6 Vulosja e Sistemit te Matjes nga OST**
- III.7 Vulosja e Sistemit te Matjes nga OSSH dhe Furnizuesit**
- III.8 Karakteristikat e Vules**

KAPITULLI IV – KERKESAT TEKNIKE PER KONSUMATORET FUNDORE

- IV.1 Ndertimi dhe Mirembajtja e Sistemit te Matjes**
- IV.2 Vendndodhja e Matsit**
- IV.3 Paisjet e Testimit te Matesit**

- IV.4 Kerkesat per Saktesine e Matesit**
- IV.5 Vendndodhja dhe Metodatat e Testimit te Matesit**
- IV.6 Testet Primare te Matesit per Instalim**
- IV.7 Testet Periodike te Matesave Vat – Ore**
- IV.8 Testet me Kerkese te Konsumatorit**
- IV.9 Pasaktesite e Matjes (Metering)**

KAPITULLI V – HYRJA NE FUQI

SHTOJCAT:

- Shtojca A – Termat dhe Percaktimet per Kodin e Matjes ne Shqiperi**
- Shtojca B – Termat dhe percaktimet per Rregullat e Tregut, Kodin e Rrjetit te Transmetimit, Kodin e Shperndarjes dhe Kodin e Matjes ne Shqiperi**

KAPITULLI I – PARATHENIE**I.1 Hyrje**

- I.1.1 Ristrukturimi i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe liberalizimi i Tregut të Energjisë Elektrike kërkon përdorim të furnizimit, transaksione (shitje-blerje) dhe shkëmbime të Energjisë Elektrike midis Pjesëmarrësve të Tregut.
- I.1.2 Furnizimi, transaksionet dhe shkëmbimet e Energjisë Elektrike duhet të maten dhe monitorohen në kufij të ndarë të pjesëmarrësve të Tregut të Energjisë Elektrike, të shoqëruar me transaksionet financiare mbi bazën e marrëveshjeve përkatëse.
- I.1.3 Të gjitha marrëveshjet e lidhura për furnizimin, transaksionet dhe shkëmbimet e Energjisë Elektrike midis Paleve do të bazohen në termat dhe Rregullat e Tregut.
- I.1.4 Kodi i Matjes përcakton kërkesat teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes të Energjisë Elektrike, që do të jetë i përshtatshëm për matje, për mbledhjen e të dhënave, regjistrimin e tyre dhe zbatimin e procedurave përkatëse sipas Rregullave të Tregut dhe Marrëveshjeve midis Paleve.
- I.1.5 Paisjet matëse do të sigurohen nga të gjithë Pjesëmarrësit e Tregut, që detyrohen nga Legjislacioni në fuqi, dhe do të jenë të regjistruara në Sistemin e Regjistrimit të Matesave (SRM) dhe në përputhje me termat e Kodit të Matjes si dhe në përputhje me ligjin Nr.8996 datë 30.01.2003 “Për njesitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjine)”.
- I.1.6 Kodi i Matjes është ndarë në katër pjesë kryesore:
- i. Shpjegime
 - ii. Kërkesa të përgjithshme
 - iii. Kërkesa Teknike
 - iv. Kërkesa Teknike për Konsumatorët Fundorë

Shtojca – Termat dhe Përcaktimet

I.2 Shpjegime

- I.2.1 Në vijim janë disa nga Shpjegimet e Kodit të Matjes:
- i. Përveç se kur është kërkuar ndryshe, termi “inspektor” do të nënkuptojë çdo individ ose çdo subjekt i cili quhet i tillë në bazë të Legjislacionit në fuqi;
 - ii. Çdo referencë në Legjislacionin në fuqi, në rregulloret, direktivat, udhëzimet, kodet, do të përfshijë gjithashtu edhe të gjitha amendamentet, shtojcat, modifikimet dhe zëvendesimet përkatëse që mund të kenë;
 - iii. Referencë në termin “me shkrim” përfshin çdo formë të shkrimit të fjaleve dhe shtypjen e tyre në një formë legale dhe të ligjshme.

KAPITULLI II – KERKESA TE PERGJITHESHME

II.1 Qellimi

- II.1.1 Kodi i Matjes permban normat minimale te detyrueshme per matjen dhe rregjistrimin e Energjise Elektrike, me qellim tregetimin e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise.
- II.1.2 Sipas marreveshjeve te vendosura, Energjia Elektrike (MWh dhe MVARh), e eksportuar dhe e importuar ne çdo pike matjeje duhet te jete e matur dhe regjistruar me anen e paisjeve matese te instaluara dhe te mirembajtura sipas kushteve te Kodit te Matjes.
- II.1.3 Kodi i Matjes do te zbatohet nga gjithe Pjesmarresit e Tregut si me poshte:
- i. Te gjithe Gjeneruesit
 - ii. OST
 - iii. OSSH
 - iv. Furnizuesit
 - v. Furnizuesit e Kualifikuar vendas dhe te huaj
 - vi. Klientet e Kualifikuar
 - vii. Klientet tarifore (vetem ne kuptimin e zbatimit te ketij Kodi).

II.2 Objekti

- II.2.1 Kodi i Matjes percakton praktiken qe do te perdoret dhe kushtet qe do te zbatohen per matjen dhe rregjistrimin e Energjise Elektrike ne perputhje me Rregullat e Tregut.
- II.2.2 Kodi percakton dhe specifikon keto kushte kryesore per sistemin e matjes si ne vijim:
- i. Kriteret teknike dhe standartet e ndertimit dhe te shfrytezimit te sistemit te matjes
 - ii. Saktesine dhe kalibrimin
 - iii. Verifikimin e ekzistences se çertifikimit dhe testimin
 - iv. Leximin, rregjistrimin dhe perpunimin e te dhenave te matjes, etj

II.3 Kerkesa te Pergjitheshme per Paisjet e Matjes

II.3.1 Standartet

- II.3.1.1 Sistemet e matjes dhe pjeset perberese te saj do te jene ne perputhje me normat e percaktuara ne Kodin e Matjes si dhe ligjin Nr.8996, date 30.01.2003 “Per njesite e matjes dhe kontrollin e mjeteve matese (metrologjine)”.

- II.3.1.2 Komisioni i Kodit te Matjes do te shqyrtoje dhe diskutoje çdo norme te re, si dhe udhezime te organizmave nderkombetare per sistemin e matjes dhe do te propozojte per miratim ne ERE.
- II.3.1.3 Ne qofte se paisjet ekzistuese te sistemit te matjes nuk jane ne perputhje me standartet nderkombetare dhe kerkesat e saktetise te pershkruara ne paragrafet e Kodit te Matjes do te realizohet zevendesimi i tyre nga Palet respektive.
- II.3.1.4 Per sistemin e matjes do te perdoret nje protokoll komunikimi i percaktuar dhe specifikuar sipas Rregullave te Tregut, Marreveshjeve midis Paleve dhe ketij Kodi.

II.3.2 Saktesia e Sistemit te Matjes

- II.3.2.1 Sistemi i matjes do te jete me saktesi brenda kufijve te percaktuar ne Kodin e Matjes, standartet nderkombetare si dhe Legjislacionit ne fuqi.
- II.3.2.2 Kerkesat e ketij Kodi do te zbatohen njesoj per matesat kryesore dhe per matesat e kontrollit.

II.4 Verifikimi i Ekzistences se Çertifikimit dhe Testimi i Sistemit te Matjes

II.4.1 Pergjegjesite e OSSH-es, Furnizuesit, Furnizuesit te Kualifikuar, OST-es dhe Gjeneruesit

- II.4.1.1 **Kompania (te) e Gjenerimit, Furnizuesit dhe Furnizuesit e Kualifikuar jane pergjegjes per:**
- i. Verifikimin e ekzistences se çertifikimit dhe testimit te sistemit te matjes qe zoterohen nga Kompanite e Gjenerimit, Furnizuesit dhe Furnizuesit te Kualifikuar sipas kerkesave te Kodit te Matjes, standarteve nderkombetare dhe Legjislacionit ne fuqi.
 - ii. Regjistrimin dhe evidentimin e te dhenave te te gjitha sistemit te matjes qe lidhet me kalibrimin si edhe me rezultatet e çdo testi. Keto rregjistrime gjithashtu mund te perfshijne edhe detaje te tjera te dhenash qe do te konsiderohen te pranueshme nga Pjesemarresit e Tregut. Rregjistrimet duhet te jene te plota dhe te sakta sipas parametrave te sistemit te matjes.
 - iii. Vulosjen per te gjitha Kompanite e Gjenerimit, Furnizuesit dhe Furnizuesit e Kualifikuar te sistemit te matjes, paisjeve te mbledhjes dhe te regjistrimit te te dhenave, si dhe te paisjeve te komunikimit sic jane modemmat ose telefonat.
- II.4.1.2 **OST eshte pergjegjese per:**
- i. Verifikimin e ekzistences se çertifikimit te sistemit te matjes qe zoterohet nga OST, sipas kerkesave te Kodit te Matjes, standarteve nderkombetare dhe Legjislacionit ne fuqi.

- ii. Instalimin e sistemit te matjes dhe matesit, si dhe per paisjet e matjes te Konsumatoreve qe jane lidhur ne Sistemin e Transmetimit. Keto paisje duhet te jene sipas kerkesave dhe normave te ketij Kodi, standarteve nderkombetare dhe Legjislacionit ne fuqi dhe te jene te regjistruara ne Sistemin e Rregjistrimit te Matjes (SRM).
- iii. Ruajtjen e rregjistrimeve dhe te dhenave per te gjithë sistemin e matjes qe lidhet me kalibrimin si edhe me datat dhe rezultatet e çdo testi, leximet apo rregullimet. Gjithashtu ne keto rregjistrime mund te perfshihen edhe detaje te tjera te dhenash qe do te konsiderohen te pranueshme nga Pjesemarresit ne Treg. Çdo rregjistrim do te jete i plote dhe i sakte sipas parametrave te sistemit te matjes. Ne linjat e interkonjeksionit instalohen sisteme matje ne perputhje me standartet nderkombetare dhe Marreveshjet dy paleshe me OST-te e vendeve fqinjë.

II.4.1.3 Gjeneruesit jane pergjegjes per:

- i. Verifikimin e ekzistences se çertifikimit te sistemit te matjes qe zoterohet nga Gjeneruesit sipas kerkesave te Kodit te Matjes, standarteve nderkombetare dhe Legjislacionit ne fuqi.
- ii. Instalimin e sistemit te matjes dhe matesit, si dhe per paisjet e matjes te instaluar ne sistemet/objektet e tyre. Keto paisje duhet te jene sipas kerkesave dhe normave te ketij kodi, standarteve nderkombetare dhe Legjislacionit ne fuqi dhe te jene te regjistruara ne Sistemin e Rregjistrimit te Matjes (SRM).
- iii. Ruajtjen e rregjistrimeve dhe te dhenave per te gjithë sistemin e matjes qe lidhet me kalibrimin si edhe me datat dhe rezultatet e çdo testi, leximi apo rregullimi.
- iv. Gjithashtu ne keto rregjistrime mund te perfshihen edhe detaje te tjera te dhenash qe do te konsiderohen te pranueshme nga Pjesemarresit e Tregut. Çdo rregjistrim do te jete i plote dhe i sakte sipas parametrave te sistemit te matjes

II.4.2 Verifikimi i Ekzistences se Çertifikimit te Matsave

- II.4.2.1 Matesat e perdorur ne perputhje me kete Kod do te jene te çertifikuar.
- II.4.2.2 Te gjitha paisjet e reja te matjes do te kerkohet qe te kene kaluar testet dhe te jene te çertifikuara sipas Legjislacionit ne fuqi.
- II.4.2.3 Teste do te kryhen ne perputhje me standartet perkatese IEC te pershkruara ne kete Kod, Legjislacionin ne fuqi dhe me Direktiven e Bashkimit European per Instrumentat e Matjes.
- II.4.2.4 Jetegjatesia e matesave do te jete e specifikuar ne certifikate. Zgjatja e vlefshmerise te kesaj çertifikate mund te jete e ndryshme per tipe te ndryshme matesash dhe mund te ndryshoje kohe pas kohe. Per te gjithë sistemet e matjes dhe matesat kerkohet certifikimi i vules. Vula duhet te mbetet e pademtuar ne menyre qe matesi te kete statusin e plote te te qenit i çertifikuar.
- II.4.2.5 Ne rast nderhyrje ne mates ose ne sistemin e matjes, vula duhet te demtohet ne menyre te pakthyeshme.

II.4.2.6 Matesat e hequr nga funksionimi duhet te testohen perseri sipas ketij Kodi perpara rilidhjes te tyre per perdorim.

II.4.3 Inspektimi dhe Testimi

II.4.3.1 Te gjithë matesat, transformatorët e rrymes dhe te tensionit dhe paisjet e tjera te sistemit te matjes, do te jene te testuar per saktesine e tyre perpara se te vihen ne pune. Testimet duhet te behen ne periudha te caktuara kohore per te kontrolluar dhe verifikuar qe funksionimi i matjes eshte brenda kufijeve te lejuar te gabimit te dhene ne Kodin e Matjes.

II.4.3.2 Testimi do te realizohet sipas grafikut kohor te paraqitur me poshte.

| Niveli i fuqise | > 50 MVA | 10 MVA – 50 MVA | 1 MVA – 10 MVA | < 1 MVA |
|---------------------|----------|-----------------|----------------|---------|
| Periudha e Testimit | 2 vite | 3 vite | 4 vite | 5 vite |

II.4.3.3 OSSH, Furnizuesit, Furnizuesit e Kualifikuar, OST dhe Gjeneruesit mund ti ndryshojne keto periudha kohore, me miratim nga ERE, ne baze te performances dhe karakteristikave te sistemit te matjes.

II.4.3.4 Matesi i vendosur ne objekt rekomandohet te jete i pajisur me terminale te testimit ne menyre qe te kete mundesi per te punuar ne objekt. Keto terminale duhet te jene afer matesit. Ky rekomandim lihet ne gjykimin dhe marreveshjen midis Paleve.

II.4.3.5 Si shtese, rekomandohet nese matesi i vendosur ne objekt nuk eshte i pajisur me terminale, gjate periudhes se testimit te tij te zevendesohet me nje mates te testuar dhe te certifikuar.

II.4.3.6 Te gjitha Palet duhet te informohen per testet, te jene te ftuar per te marre pjese dhe rezultatet e ketyre testeve te jene ne dispozicion te çdo Pale.

II.4.3.7 Testet duhet te kryhen ne menyre te tille qe te minimizohen dhe te shmangen nderprerjet e matjes se Energjise Elektrike ku paisjet jane instaluar.

II.4.3.8 Per kryerjen e testeve do te perdoren pajisje te certifikuara te testimit sipas Legjislacionit ne fuqi dhe standartet perkatese dhe neqoftese gjykohet e nevojshme (sipas nje marreveshje midis paleve) mund te perdoren paisjet dhe kushtet qe ofron nje laborator i autorizuar sipas ligjit Nr. 8996 date 30.01.2003. “Per njesite e matjes dhe kontrollin e mjeteve matese (metrologjine)”.

II.4.3.9 Nese testi tregon nje gabim qe kalon kufijte e gabimit te pershkruar ne kete Kod atehere keto gabime do te rregjistrohen perpara rregullimit, riparimit te paisjes matese apo te nje pjese te saj ose para zevendesimit te komponenteve te difektuar.

II.4.4 Inspektimi dhe Testimi ne Raste te Veçanta

- II.4.4.1 Eshte e pranueshme qe pervec inspektimeve normale sipas paragrafit II.4.3 te kryhen edhe inspektime speciale ose te veçanta per sistemin e matjes dhe sistemet e tyre te rregjistrimit nga Pjesemarresit e Tregut. Per keto inspektime do te zbatohet neni 51 i Ligjit Nr.9072, date 22.5.2003 “Per sektorin e Energjise Elektrike”, i ndryshuar.
- II.4.4.2 Matesi duhet te testohet edhe jashte kufijve te lejuar te matjes. Nese pas kontrollit midis matesit kryesor dhe atij te kontrollit ka nje devijim me te madh se 1.5 here nga kufijte e lejuar te gabimit te permendur ne Kod, atehere matesi duhet te zevendesohet ose te rregullohet ne menyre qe te permbushe standartet nderkombetare dhe normat e ketij Kodi.

II.5 Pjesemarresit e Tregut

- II.5.1 Pjesemarresit e Tregut do te garantojne dhe do te sigurojne qe i gjithe sistemi i te dhenave eshte mbledhur dhe rregjistruar sipas procedurave te percaktuara ne Rregullat e Tregut si dhe Marreveshjes per Pjesemarrje ne Treg te Paleve dhe procedurat per vlefshmerine, vleresimin, zevendesimin dhe bashkimin e ketyre te dhenave sipas kerkesave te Rregullave te Tregut.

II.6 Kerkesat per Matesat dhe Rregjistrimi

- II.6.1 Pjesemarresit ne Treg, konform legjislacionit ne fuqi, do te sigurojne, instalojne dhe mirembajne te gjithe sistemet e matjes te cilet do te jene te rregjistruar ne Sistemin e Rregjistrimit te Matesave (SRM)
- II.6.2 **OST do te jete pergjegjes per:**
- i. sigurimin, instalimin dhe mirembajtjen e sistemit te matjes dhe matjen ne kufijte e Sistemit te Transmetimit dhe tek Konsumatoret e energjise elektrike te lidhur ne te.
 - ii. sigurimin, instalimin dhe mirembajtjen e sistemit te matjes dhe matjen ne linjat e interkonjeksionit. Keto sisteme matje do te jene sipas normave te ketij Kodi e standarteve nderkombetare dhe do te jene te rregjistruar ne SRM.
- II.6.3 **OSSH, do te jene pergjegjes per:**
- i. sigurimin, instalimin dhe mirembajtjen e sistemit te matjes dhe matjen ne kufijte ku Konsumatoret (Perdoruesit) jane te lidhur me Sistemin e Shperndarjes. Konsumatoret (Perdoruesit) qe lidhen ne Sistemin e Shperndarjes mund te jene Kliente Tarifor dhe Kliente te Kualifikuar. Persa i perket Klienteve te Kualifikuar sistemi i matjes instalohet nga OSSH ose Furnizuesit e Kualifikuar per llogari ose te Klientit te Kualifikuar, sipas marreveshjes midis Paleve. Keto sisteme matje do te jene sipas normave te ketij Kodi e standarteve nderkombetare dhe do te jene te rregjistruar ne SRM

II.6.4 Gjeneruesit do te jene pergjegjes per:

- i. sigurimin, instalimin dhe mirembajtjen e sistemit te matjes dhe matjen ne piken e matjes (pika ku matet Energjia Elektrike) si dhe per sistemet e matjes te instaluara ne sistemet/objektet e tyre. Keto sisteme matje do te jene sipas normave te ketij Kodi e standarteve nderkombetare dhe do te jene te regjistruar ne SRM.

II.6.5 Te dhenat e rregjistruara ne Sistemin e Rregjistrimit te Matjeve (SRM) do te jene konfidenciale dhe do te administrohen nga Pala perkatese ne perputhje me Rregullat e Tregut.

II.6.6 SRM do te permbaje te pakten keto specifikime per sistemet e matjes dhe matesat per çdo pike matje:

- i. Specifikimet teknike te matesit
- ii. Numrin serial
- iii. Numrin e thirrjes (per matesat me kontrollin ne distance)
- iv. Vleren e impulseve mates
- v. Te dhena te transformatoreve te matjes (transformatore rryme, transformatore tensioni)
- vi. Çertifikatat e paisjeve te sistemit te matjes (per ato qe jane)
- vii. Piken e lidhjes/adresen e objektit ku eshte lidhur matesi
- viii. Numri ID (identifikues) i konsumatorit(Perdoruesit)
- ix. Numri ID (identifikues) i furnizuesit
- x. Data e instalimit
- xi. Testet e kontrollit
- xii. Teste te ndryshme sipas kerkesave etj.

II.6.7 SRM do te kete te rregjistruar deri ne ditene aktuale çdo ndryshim te Perdoruesve dhe Konsumatoreve, paisjeve matese dhe çdo shkeputje te lidhjeve te tyre. Çdo informacion tjetër ne lidhje me çdo pike matjeje qe mund te kerkohet nga Pjesemarresit e Tregut duhet te jete i rregjistruar ne SRM.

II.6.8 SRM do te ruaje informacionin qe kerkohet ne kete paragraf per nje periudhe kohore minimumi 10 vjet per çdo pike matje.

II.6.9 Te dhenat e SRM do te jene te vlefshme per subjektet apo persona fizik e juridik sipas kerkeses te tyre dhe sipas formatit te percaktuar nga Kodi i Matjes.

II.7 Menaxhimi i te Dhenave te Matjes

II.7.1 Rregjistrimi i te Dhenave te Matjes

II.7.1.1 Te dhenat ne lidhje me sasine e Energjise Elektrike te eksportuar dhe te importuar nga çdo Pjesemarres i Tregut rregjistrohen, vleresohen dhe perpunohen sipas kerkesave te ketij Kodi. Vleresimi dhe zevendesimi i te dhenave do te behet edhe sipas percaktimeve ne Marrevshjet midis Paleve.

II.7.1.2 **OST** do te rregjistroje leximin e te dhenave te matjes per :

- i. Te gjithë Perdoruesit e Sistemit te Transmetimit duke perfshire Gjeneruesit, OSSH, Konsumatoret e lidhur direkt ne Rrjetin e Transmetimit si dhe Furnizuesit dhe Klientet e Kualifikuar;
- ii. Linjat e interkonjeksionit.

II.7.1.3 **Gjeneruesit** do te rregjistrojne te dhenat e matjes ne piken e tyre te lidhjes.

II.7.1.4 **OSSH** do te regjistrojne te dhenat e matjes per:

- i. Klientet Tarifore ;
- ii. Gjeneruesit e lidhur ne Sistemin e Shperndarjes ;
- iii. Furnizuesit e Kualifikuar dhe Konsumatoret e Kualifikuar qe perdorin Sistemin e Shperndarjes

II.7.1.5 **Furnizuesit** do te rregjistrojne te dhenat e matjes perkatesisht ne piken/pikat perkatese te shitjes/blerjes se energjise elektrike.

II.7.1.6 **Furnizuesit e Kualifikuar dhe Konsumatoret e Kualifikuar** do te rregjistrojne te dhenat e matjes ne piken e lidhjes se tyre sipas marrveshjeve midis Paleve.

II.7.2 Metoda e Rregjistrimit te te Dhenave te Matjes

II.7.2.1 Ne pergjithesi sistemet e rregjistrimit te te dhenave te matjes rekomandohet te kontrollojne ne distance sistemin e matjes dhe te marrin te dhenat ne intervale te caktuara kohore. Intervali kohor i marrjes se te dhenave percaktohet ne Rregullat e Tregut dhe me marrevshje midis Paleve.

II.7.2.2 Pervec kontrollit dhe marrjes se te dhenave ne distance duhet te parashikohet qe te kete mundesi per marrjen e te dhenave ne menyre manuale nga rregjistruesit lokal. Per Klientet fundore ne pergjithesi dhe Klientet Tarifore ne veçanti, rregjistrimi i te dhenave te matjes te behet me leximin direkt nga matesi.

II.7.2.3 Kontrolli ne distance do te realizohet me anen e mjeteve te meposhteme te komunikimit:

- i. rrjetit telefonik ekzistues;
- ii. linjave te dedikuara te telekomunikacionit;
- iii. lidhjeve me anen e fibrave optike;
- iv. radiove rele

- v. sistemit GSM
- vi. sisteme te tjera te pershtatshme komunikimi

Si dhe duke perdorur protokolle sipas standarteve nderkombetare dhe te rena dakort ne marreveshjet midis Paleve.

II.7.2.4 Te dhenat qe do te merren nga matesit per çdo sistem te matjes do te jene si me poshte:

II.7.2.5 Per Klientet Tarifore:

- i. Per klientet familjare per lidhje ne TU:.....Energjia elektrike aktive
- ii. Per kliente jofamiljare per lidhje ne TU.....Energji elektrike aktive dhe reaktive sipas V.K.M perkates
- iii. per lidhje ne TM : Energjia elektrike aktive
.....Energjia elektrike reaktive
.....Fuqia elektrike aktive
.....Fuqia elektrike reaktive
.....cosφ

II.7.2.6 Per Klientet e Kualifikuar:

- i. Energjia elektrike aktive
- ii. Energjia elektrike reaktive
- iii. Fuqia elektrike aktive
- iv. Fuqia elektrike reaktive
- v. cosφ
- vi. Parametra te tjere qe do te vendosen me marreveshje midis Paleve

II.7.2.7 Per Gjeneruesit:

- i. Energjia elektrike aktive
- ii. Energjia elektrike reaktive
- iii. Fuqia elektrike aktive
- iv. Fuqia elektrike reaktive

II.7.2.8 Per OST:

- i. Energjia elektrike aktive
- ii. Energjia elektrike reaktive
- iii. Fuqia elektrike aktive
- iv. Fuqia elektrike reaktive
- v. $\cos\varphi$

II.7.2.9 Per OSSH:

Per çdo fider ne TM (35 kV, 20 kV, 10 kV, 6 kV):

- i. Energjia elektrike aktive
- ii. Energjia elektrike reaktive
.....Fuqia elektrike aktive
.....Fuqia elektrike reaktive
..... $\cos\varphi$

II.7.2.10 Per cdo kabine TM/TU:

- i. Energjia elektrike aktive
- ii. Energjia elektrike reaktive (matja ne TU)

II.7.2.11 Parametrat e paraqitur me larte jane kerkesat minimale, por parametra te tjere do te vendosen me marreveshje midis Paleve.

II.7.3 Matja dhe Perpunimi i te Dhenave

II.7.3.1 Sistemi i matjes duhet te jete i mbrojtur nga nderhyrjet lokale dhe ato ne distance.

II.7.3.2 Parametrat e permendur ne kete Kod duhen rregjistruar dhe ruajtur ne perputhje me normat e paraqitura ne paragrafet e ketij Kodi si dhe ne marreveshjen midis Paleve.

II.7.3.3 **OSSH** duhet te instaloje programe Informatike te cilet realizojne proçesin e automatizuar te shitjes, blerjes dhe te balances se Energjise Elektrike.

II.7.3.4 Menuja kryesore e programit informatik duhet te shprehi zerat qe lidhen me te dhenat kryesore te nje klienti tariferor i lidhur dhe i furnizuar ne TM ose TU, dhe SRM per çdo klient duhet te siguroje dhe hedhjen e te dhenave kryesore qe identifikojne klientin dhe parametrat e tij.

II.7.3.5 OST duhet te instaloje programe Informatike te cilet realizojne proçesin e automatizuar te shitjes, blerjes, balances, shkembimeve dhe transaksioneve te Energjise Elektrike si dhe te dhenat kryesore qe identifikojne Perdoruesin dhe parametrat e tij.

- II.7.3.6 Gjeneruesit duhet te instalojne programe Informatike te cilet realizojne procesin e automatizuar te shitjes, blerjes, dhe te balances se Energjise Elektrike.
- II.7.3.7 Kerkesat per Energji Elektrike do te rregjistrohen dhe mbahen ne perputhje me standartet dhe procedurat e Rregullave te Tregut, Kodit te Rrjetit dhe paragrafeve te ketij Kodi. Ruajtja e te dhenave, perputhja e leximeve te rregjistruara dhe administrimi i situatave te emergjences ne rast defekti te paisjeve matese do te jene ne perputhje me Rregullat e Tregut ose ne mareveshjen midis Paleve
- II.7.3.8 Te dhenat do te jene te vlefshme dhe sipas Rregullave te Tregut dhe Kodeve perkatese te Rrjetit dhe te Shperndarjes. Ne pergjithesi, te dhenat do te jene botuar ne çdo kohe dhe zevendesimi apo ndryshimi i tyre do te behet sipas kushteve dhe rregullave te vendosura ne Marreveshjen midis Paleve.
- II.7.3.9 Sistemi i perpunimit te te dhenave protokollohet dhe komunikimet e tyre do te jene ne perputhje me kushtet dhe rregullat e vendosura ne Marreveshje midis Paleve edhe sipas Legjislacionit ne fuqi.
- II.7.3.10 Si rregull i pergjithshem per çdo mates te rregjistruar, te dhenat e tij do te ruhen ne menyre informatike gjate gjithe kohes te perdorimit te tij.

II.7.4 Leximi i Matesit

- II.7.4.1 Tregimi i matesit do te lexohet dhe do te rregjistrohet per çdo muaj per te realizuar balancen e Energjise Elektrike (shitje- blerje, Transaksione, shkembime).
- II.7.4.2 Palet mund te bien dakort qe leximi i tregimit te matjes te behet dhe ne periudha te ndryshme me marreveshje midis Paleve.
- II.7.4.3 Ne disa raste, ose me marreveshje midis Paleve, leximi i tregimit te matesit mund te behet dhe ne distance (on –line).

II.7.5 Mosfeksionimi i Sistemit te Matjes

- II.7.5.1 Ne rast kur te dhenat e matjeve nuk jane te vlefshme si rezultat i defekteve ne paisjet e komunikimit ose ne sistemin qendror te te dhenave, atehere do te perdoren te dhenat e marra nga paisjet lokale te montuara tek matesi (p.sh. rregjistruesi lokal etj).
- II.7.5.2 Ne rastet kur te dhenat nuk jane te vlefshme per shkak te defekteve dhe mosfeksionimit te matesit te vendosur ne objekt, transformatorit te rrymes, te tensionit, kabllimit, paisjeve mbrojtese ose ne rastet kur matesi i vendosur ne objekt punon jashte kufjve te lejuar te gabimit, atehere marrja e te dhenave te matjes do te te percaktohet me mareveshje ndermjet Paleve, ne perputhje me rregullat e miratuara nga ERE.

II.8 Mbrojtja nga Nderhyrjet dhe Demtimet

- II.8.1 OSSH dhe Furnizuesit duhet te verifikojne konsumin e Energjise Elektrike te rregjistruar ne çdo pike matje per te percaktuar konsumin real per konsumatoret fundor.

- II.8.2 Ne rast te nderhyrjeve te paligjshme ose perdorimit te paautorizuar te Energjise Elektrike, OSSH dhe Furnizuesit do te zbatohet Legjislacionin ne fuqi ne Territorin e Republikes se Shqiperise.
- II.8.3 Kur matesi ose pjese te matesit jane jashte funksionit apo punojne jashte kufijve te lejuar te gabimit, atehere merren masa per rregullimin, riparimin ose zevendesimin e tyre ose te pjeseve te demtuara duke bere te mundur kthimin ne pune te paisjes sipas kerkesave te lejuara per kufijte e gabimit.
- II.8.4 Konsumatoret do te perdorin me kujdes dhe do ti ruajne paisjet e matjes kur ato jane te vendosur brenda kufijve te pronesise se konsumatorit. Ne rast se ata verifikojne demtim te paisjes matese atehere do te lajmerojne me shkrim subjektin qe siguron paisjet sipas marreveshjes per ta riparuar ose zevendesuar.

II.9 Kërkesa ndaj Perdoruesit dhe Konsumatoreve Fundor

- II.9.1 Perdoruesit ose Konsumatoret fundor duhet te lejojne qe OST, OSSH, Furnizuesi Publik me Pakice , ose ndonje person tjetër i autorizuar nga legjislacioni ne fuqi te hyje ne godinat dhe objektet e tyre ku konsumohet energjia elektrike, me qellim qe te kontrolloje dhe te zbatohet rregullat dhe detyrimet sipas Kodit te Matjes dhe Legjislacionit ne fuqi.
- II.9.2 Sipas ketij paragrafi e drejta per te nderhyre perfshin te drejten e personave te autorizuar per te kontrolluar, verifikuar, dhe per te realizuar punime te nevojeshme ne territorin e Perdoruesit ose Konsumatorit per çdo mates apo paisje matese me qellim Implementimin e Kodit te Matjes dhe te Legjislacionit ne Fuqi.

II.10 Perberja e Komisionit te Kodit te Matjes (KKM)

- II.10.1 **Komisioni perbehet nga:**
- i. Kryetari caktohet nga OSSH
 - ii. Sekretari caktohet nga OSSH
 - iii. Nje antar i cili perfaqeson Furnizuesin Publik me Pakice
 - iv. Nje antar i cili perfaqeson Furnizuesin Publik me Shumice
 - v. Nje antar i cili perfaqeson OST
 - vi. Nje antar i cili perfaqeson KESH Gjen.
 - vii. Nje antar i cili perfaqeson Impiantet e Pavarur Prodhues
 - viii. Nje antar i cili perfaqeson Impiantet e Vegjel Prodhues
 - ix. Nje antar i cili perfaqeson te gjithe Furnizuesit e Kualifikuar
 - x. Nje antar i cili perfaqeson Klientet e Kualifikuar
 - xi. Nje antar i cili perfaqeson interesat e Klienteve Tarifore

- II.10.2 Brenda 15 diteve pas hyrjes ne fuqi te ketij Kodi, OSSH do te caktoje Kryetarin e KKM.
- II.10.3 Brenda 30 diteve pas hyrjes ne fuqi te ketij Kodi; Kryetari do njoftoje perfaqesuesit e tjere te caktuar nga Palet ne kete Komision.
- II.10.4 Brenda 15 diteve nga marrja e ketij informacioni, te gjitha Palet jane te detyruar ti dergojne Kryetarit nje pergjigje me shkrim per emerimin e perfaqesueseve te tyre.
- II.10.5 Kryetari do te therrese mbledhjen e pare brenda 60 diteve nga hyrja ne fuqi, per te miratuar rregulloren e funksionimit te Komisionit.
- II.10.6 Vendimet e KKM do te merren me konsensus dhe do te dergohen ne ERE per miratim. Ne qofte se nuk arrihet konsensusi ceshtja referohet ne ERE per vendim. ERE do te njoftoje palet mbi vendimin e marre. Vendimi i ERE-s pasqyrohet ne Kod nese gjykohet nga ajo se eshte pjese e nje modifikimi te Kodit.
- II.10.7 Modifikimet e Kodit te Matjes nuk do te zbatohet pa u miratuar ne ERE.

II.11 Funkcionet e Komisionit te Kodit te Matjes (KKM)

- II.11.1 KKM do te kryej funksionet e meposhteme:
- i. Rifreskimin e Kodit te Matjes sipas sugjerimeve te bera nga Palet dhe i parashtron ne ERE per miratim.
 - ii. Ben rekomandime dhe rifreskime te Kodit te Matjes kur i gjykon te nevojshme duke dhene dhe arsyet perkatese, dhe i parashtron ne ERE per miratim.
 - iii. Ndhimon ne interpretimin e Kodit te Matjes sipas kerkesave te bera nga Palet pjesemarrrese ne Tregun e Energjise Elektrike.
 - iv. Merr ne shqyrtim dhe konsideron objekt te aktivitetit te tij çdo ndryshim qe konsiderohet i nevojshem ne Kodin e Matjes per shkak te rrethanave te paparashikuara nga ky Kod.
 - v. Pershtat Kodin e Matjes me udhezimet dhe standartet nderkombetare dhe i parashtron ne ERE per miratim
 - vi. Adreson te gjitha rastet e deshtimeve ne permbushjen e kushteve dhe standarteve te ketij Kodi te paraqitura nga Palet dhe i parashtron ato ne ERE me argumentat respektiv.

II.12 Informacioni

- II.12.1 Paleve do t'u jepet akses, per te pare çdo informacion ne lidhje me matesat dhe paisjet e matjes sipas kerkesave te Mareveshjeve bilaterale, Kodit te Matjes dhe Legjislacionit ne Fuqi.

II.13 Njoftimi

- II.13.1 OST, OSSH dhe Furnizuesi Publik me Pakice duhet te njoftohen per çdo ndryshim te Perdoruesit apo Konsumatorit.

KAPITULLI III – KERKESAT TEKNIKE**III.1 Hyrje**

III.1.1 Kodi i Matjes percakton kerkesat teknike ne lidhje me sistemin e matjes (dhe regjistrimin ne pikat e matjes.

III.2 Referencat

III.2.1 Dokumentat e meposhtem jane perdorur si referenca ne percaktimin e standarteve dhe kushteve teknike te Kodit te Matjes:

- i. IEC Standard 60687 – Alternating Current Static Watt-Hour Meters for Active Energy (Cl. 0.2S and 0.5 S).
- ii. IEC Standard 61036 – Alternating Current Static Watt-Hour Meters for Active Energy (Cl. 1 and 2).
- iii. IEC Standard 61268 – Alternating Current Static Watt-Hour Meters for Reactive Energy (Cl. 2 and 3).
- iv. IEC Standard 60044 – 1 – Instrument Current Transformer ICT.
- v. IEC Standard 60044 – 2 – Instrument Voltage Transformer IVT.
- vi. IEC Standard 60044 – 3 – Instrument Transformers – Combined Transformers.
- vii. IEC Standard 61107– Data Exchange for meter reading – direct local data exchange.

III.3 Pikat e Matjes

III.3.1 Pikat e matjes do te vendosen ne kufijte e pronesise se Klientit, apo Perdoruesit ose mbi bazen e marreveshjeve te lidhura midis Paleve.

III.3.2 Pika e lidhjes mund te jete e ndryshme nga pika e matjes dhe ky fakt eshte objekt aprovimi i Paleve ne Marevshje. Ne keto raste, kerkesat e saktetise per matjen do te zbatohen ne piken e matjes.

III.4 Standartet e paisjeve Matese

III.4.1 Te gjitha paisjet e matjes do te jene ne perputhje me kerkesat dhe kushtet e Kodit te Matjes. Keto kerkesa dhe kushte mund te rishikohen here pas here nga Komisioni dhe miratohen nga ERE, me qellim qe te merret ne konsiderate çdo ndryshim i teknologjise apo kerkesave teknike qe lidhen me zhvillimin industrial si dhe udhezimet nderkombetare.

III.4.2 Matesat duhet te jene te instaluar ne nje kuti (boks individual) ose kabinet (boks kolektiv ose panel). Kutia ose kabineti duhet te jete i tille qe te mbroje matesin nga lageshtira, papastertia, fushat elektromagnetike, goditjet fizike dhe te ruaje nje temeprature te pershtatshme. Kutia ose kabineti duhet te jete i siguruar me dryn dhe/ose i vulosur, me qellim qe te mos lejoje nderhyrjet e paautorizuara.

- III.4.3 Matesat ne perputhje me IEC ose IEC 61036 (ose standartin europian ekuivalent) do te jene te lidhur me transformoret e rrymes dhe te tensionit.
- III.4.4 Per realizimin e matjes, ne rast se kerkohet, do te instalohen transformatore rryme, ne perputhje me IEC Standard 60044-1 (ose standardi ekuivalent Europian) dhe transformatore tensioni ne perputhje me IEC Standard 60044 – 2 (ose Standartin ekuivalent Europian), ose do te perdoren transformatore te kombinuara te rrymes dhe tensionit, ne perputhje me “Tests for Accypracct“ te IEC Standard 6044 – 3/8.
- III.4.5 Transformoret e rrymes dhe te tensionit te jene te siguruar dhe/ose te vulosur. Nese sistemi i matjes eshte me sistem telekomunikimi dhe aksesore te tjere, duhet qe edhe keto paisje te vendosen ne kutine ose kabinetin e matjes dhe te jene te siguruar dhe te vulosura.
- III.4.6 Te gjitha paisjet e komunikimit duhet te jene ne perputhje me kerkesat e standarteve te International Telecommunications Union (ITU) dhe rekomandimeve perkatese per transmetimin e te dhenave ne sistemin e telekomunikacionit.
- III.4.7 Ruajtja e te dhenave do te behet brenda matesit ose jashte tij nepermjet paisjes se marrjes dhe ruajtjes se te dhenave. Ne rastin e dyte matesi duhet te kete nje dalje te veçante per te marre vlerat e matura.

III.5 Saktesia dhe Kufijte e Gabimit te Paisjeve te Sistemit te Matjes

- III.5.1 Saktesia e paisjeve te sistemit te matjes do te percaktohet nga vlera e fuqise se kerkuar ne piken e matjes dhe kerkesat per saktesine per paisjet e sistemit te matjes, duhet te marrin parasysh çdo ndryshim ne te ardhmen te vlerave te fuqise maksimale te kerkuar.
- III.5.2 Klasa e saktetise e bazuar ne fuqine maksimale te kerkuar (MVA) jepet ne tabelen e meposhtme.

| <i>Klasa e saktetise</i> | | | | |
|----------------------------------|----------|-----------|----------|---------|
| Fuqia maksimale e kerkuar | > 50 MVA | 10-50 MVA | 1-10 MVA | < 1 MVA |
| Tr.Rryme | 0.2s | 0.2s | 0.5s | 0.5s |
| Tr.Tensioni | 0.2 | 0.5 | 0.5 | 0.5 |
| Matesat | 0.2s | 0.5s | 1.0 | 2.0 |

- III.5.3 Per matjen e Energjise Elektrike aktive dhe reaktive paisjet e sistemit te matjes do te jene testuar dhe/ose kalibruar per te punuar brenda kufijve te lejuar te gabimit (siç paraqiten ne tabelat e meposhtme) duke marre ne konsiderate gabimet e transformatoreve te rrymes, tensionit, si dhe ato qe shkaktohen nga rezistenca omike e kabllit. Paisjet e kabllit dhe kabllimi duhet te jene te njohura dhe te zgjedhura sipas standarteve.

| Kushti | <i>Kufijte e gabimit te energjise aktive sipas Faktorit te fuqise</i> | | | | |
|---|---|--|------------------------|-----------------------|-----------------|
| | <i>Faktori i fuqise</i> | <i>Kufijte e gabimit ne Piken e Matjes</i> | | | |
| Rryma e shprehur si perqindje e vleres te rrymes nominale | | | | | |
| 10% - 120% | 1 | >50MVA ± 1.0% | 10-50 MVA ± 1.0% | 1-10 MVA ± 2.0% | <1MVA ± 3.0% |
| 5% - 10% | 1 | ± 1.5% | ± 1.5% | ± 2.5% | ± 3.5% |
| 1% - 5% | 1 | ± 2.5% | ± 2.5% | ± 3.5% | ± 4.5% |
| 10% - 120% | 0.5(-) | ± 2.0% | ± 2.0% | ± 3.0% | ± 3.5% |
| 10% - 120% | 0.5(+) | ± 2.0% | ± 2.0% | ± 3.0% | ± 3.5% |

| Kushti | <i>Kufijte e gabimit te energjise reaktive sipas Faktorit te fuqise</i> | | | | |
|---|---|--|--------------|-------------|--------|
| | <i>Faktori i fuqise</i> | <i>Kufijte e gabimit ne Piken e Matjes</i> | | | |
| Rryma e shprehur si perqindje e vleres te rrymes nominale | | | | | |
| | | >50MVA | 10-50 MVA | 1-10 MVA | <1MVA |
| 10% - 120% | 0 | ± 0.4% | ± 4.0% | ± 4.0% | ± 4.0% |
| 20% - 120% | 0.866(-) | ± 5.0% | ± 5.0% | ± 5.0% | ± 5.0% |
| 20% - 120% | 0.866(+) | ± 5.0% | ± 5.5% | ± 5.0% | ± 5.0% |

III.5.4 Te dhenat e drejperdrejta te testeve dhe te kalibrimit sipas kerkesave te mesiperme do te rregjistrohen dhe do te ruhen ne SRM.

III.5.5 Ne rastet kur transformatoret ekzistues te matjes nuk jane ne perputhje me kerkesat dhe kushtet e Kodit te Matjes atehere do te pranohet dhe zbatohen keto kushte:

- i. Kur ka ndryshime te medha te karakteristikave atehere do te instalohen transformatore te rinj te matjes ne perputhje me kerkesat e Kodit te Matjes.

III.6 Vulosja e sistemit te matjes nga OST

III.6.1 Paisjet e sistemit te matjes dhe ato te komunikimit do te jene te instaluar ne nje kabinet te sigurte dhe te vendosura ne nje vend ku mund te lexohet lehte dhe te jete i ndriçuar mire.

- III.6.2 Kabineti duhet te jete i siguruar me dryn dhe te jete i vulosur nga Palet. Kontrolli i vulosjes duhet te kryhet here pas here nga perfaqesuesi i OST . Nese vula mund te jete prishur ajo duhet te hiqet dhe te zevendesohet menjehere.
- III.6.3 Nderhyrjet ne paisjet matese dhe te komunikimit do te behet ne perputhje me procedurat dhe rregullat e percaktuara nga OST, te miratuara nga ERE, dhe ne prezenca te Paleve.
- III.6.4 Ekрани i matesit duhet te jete gjithmone i paster dhe i dukshem.
- III.6.5 OST do te kontrolloje vulat e matesave dhe pincat e vulosjes dhe do te mbaje nje rregjister te vecante per numrin dhe tipin e ketyre pincave, personave qe i kane nen kontroll. Çdo vit OST duhet te beje kontroll per gjendjen e pincave dhe te vulave.

III.7 Vulosja e Sistemit te Matjes nga OSSH

- III.7.1 Pajisjet e sistemit te matjes duhet te jene te instaluara ne kuti individuale (boks individual), panel kolektiv (boks kolektiv) ose cele matje (kur matja kryhet ne T.M) dhe te vendosura ne ambiente te vecanta apo ne vende ku mund te lexohen qarte dhe lehtesisht te kontrollueshem nga perfaqesues te autorizuar nga OSSH. Kur jane te vendosur ne panele kolektive ose individual te palexueshem, OSSH dhe/ose Furnizuesi eshte i detyruar te verifikojte leximin e matesit ne prezenca te konsumatorit brenda 7 diteve nga kerkesa me shkrim e konsumatorit.
- III.7.2 Pajisjet e sistemit te matjes duhet te jene te lehta per tu vulosur per ti mundesuar OSSH vulosjen e elementeve dhe kontakteve rryme percjellese me vula.
- III.7.3 Matesi i ri eshte i vulosur nga Prodhuesi dhe ne rastet kur OSSH nderhyn ne paisje per riparime (axhustime, vulosja do te behet me vule plumbi ose plastike nga nje laborator i autorizuar sipas kerkesave te ketij Kodi.
- III.7.4 OSSH do te beje vulosjen e morseterise se aparatit mates me vule duke qarkuar njekoheisht dhe qarkun e makinerise te matesit, ne prezenca te klientit fundor apo perdoruesit.
- III.7.5 OSSH do te mbaje dhe kontrolloje pincat e vulosjes (laboratori matjes) duke i mbajtur ne nje rregjister te vecante numrin dhe tipin e pincave.
- III.7.6 Treguesi (ekrani) i matesit duhet te jete gjithmone i paster dhe i dukshem.
- III.7.7 Nderhyrjet ne pajisjet e sistemit te matjes dhe vulat, do te behet ne perputhje me procedurat dhe rregullat e percaktuar nga OSSH ne prezenca te konsumatorit.
- III.7.8 OSSH peridiokisht, mund te beje kontroll per vulosjen e sistemit te matjes si dhe te gjendjes se pincave dhe vulave.

III.8 Karakteristikat e Vulave

- III.8.1 Vulat duhet te pergatiten me material special i cili te siguroje qe vula te mos hapet ne temperature me te ulta se $< 120^{\circ}\text{C}$ (kjo te shoqerohet me certifikaten e cilesise) apo alternative tjeter e demtushme ne menyre te pakthyeshme per ate temperature. Vula

- III.8.2 Vulat duhet te kene te shkruajtura ne njeran ane numrin e series me 6 shifra me relief, ose me incizim me teknika lazer, kurse ne anen tjeter te jete stema e OSSH.
- III.8.3 Vulosja behet me tel te viaskuar i cili duhet te kete thellesi viaske te mjaftueshme per mosshkeputjen e tij nga vula edhe per temperature sic percaktohet me siper.

KAPITULLI I V – KERKESA TEKNIKE PER KONSUMATORET FUNDOR

IV.1. Ndertimi dhe Mirembajtja e Sistemit te Matjes

- IV.1.1 Sistemi i Matjes duhet te ndertohet, te instalohet, te mirembahet dhe te operoje ne perputhje me praktiken inxhinjrike ne industrine e Energjise Elektrike dhe normat nderkombetare per te siguruar, aq sa mundesisht eshte e arsyeshme, vazhdimesine e sherbimit, uniformitetin e cilesise se sherbimit, dhe sigurine e personave dhe te prones.
- IV.1.2 OSSH duhet te aplikojte kerkesat dhe standartet teknike te percaktuara ne aktet e meposhteme si dhe ne standartet nderkombetare:
- i. Kodi i Matjes, i miratuar nga ERE
 - ii. Kodi i Shperndarjes, i miratuar nga ERE
 - iii. Kodi i Rrjetit, i miratuar nga ERE
 - iv. Kerkesat e Standarteve IEC per matjen e Energjise Elektrike dhe per instrumentat transformues
- IV.1.3 Pjesemarresit ne tregun e Energjise Elektrike duhet te adaptojne nje program te inspektimit te impiantit te tij elektrik ne menyre qe te percaktoje nevojat per zevendesim dhe riparim. Frekuenca e inspektimeve te ndryshme duhet te bazohet ne eksperiencen dhe ne praktikat e pranuar.
- IV.1.4 OSSH duhet pergatis nje harte qe tregon zonen e operimit te saj. Kjo harte duhet te perditesohet vit per vit vec nese nje kontroll i tille eshte i panevojshem, ne rast te tille OSSH duhet te lajmeroje ERE-n qe harta e rregjistruar eshte e parregullt. Si shtese e kushteve te vene ne license harta duhet te tregoje:
- i. Nen/stacionet 110/TM kV
 - ii. Linjat e T.M qe administrohen nga OSSH
 - iii. Kufijte territorial te perdorshem

IV.2 Vendndodhja e Matesit**IV.2.1 Matesit Jashte Objektivit**

- IV.2.1.1 Matesit e instaluar jashte objektivit, duhet te vendosen ne panele te sigurta dhe ne menyre te tille qe te jene te lexueshem per personat e autorizuar per leximin e matesave, testimin, dhe mirembajtjen. OSSH do te jete pergjegjese per testimin dhe mirembajtjen.
- IV.2.1.2 Matesat nuk duhet te instalohen ne vende ku lexuesit e matesave ose njerezit e sherbimit mund te demtojne mjedisin, ose aty ku ka veshtiresi te tjera per te lexuar ose per te kryer sherbime te tjera matesve. Matesat nuk duhet te vendosen ne vende ku ato mund te demtohen lehte, ose atje ku ata mund te krijojne veshtiresi per Klientin dhe OSSH-en.
- IV.2.1.3 Nese per arsye objektive matesi nuk mund te vendoset jashte objekti atehere matesi vendoset atje ku OSSH e gjykon te arsyeshme ne menyre qe te plotesoje normat e ketij Kodi.

IV.2.2 Matesat e Vendosur ne Objekt (matesi kryesor)

- IV.2.2.1 Nuk lejohet vendosja e matesave kryesor ne ndertesa qe kane me shume se nje njesi. Ne keto raste vendosen matesa te vecante per matjen e energjise elektrike ne cdo njesi te nderteses.
- IV.2.2.2 Pavaresisht nga kerkesat e paragrafit IV.2.3, matesat kryesor jane te lejuar, dhe nuk kerkohen matesa te vecante, ne rastet e meposhtme:
- i. Ne ndertesa banimi ku nje familje e vetme eshte ndare per te krijuar njesi te reja.
 - ii. Ne ndertesa studentesh ose shkolla, kolegje dhe universitete
- IV.2.2.3 Matesit kryesore jane te ndaluar ne shtepi levizese dhe kerkohen matesa te vecante te energjise elektrike nga cdo shtepi levizese.
- IV.2.2.4 Perjashtime te tjera mund te lejohen me miratim te ERE-s ne situata te vecanta ku matesi kryesor nuk eshte i pershtatshem per tu instaluar.

IV.2.3 Zevendesimi i Matsave

- IV.2.3.1 OSSH me iniciativen e vete dhe me shpenzimet e veta mund te zevendesojte nje mates kur mendon se nje gje e tille eshte e nevojshme.
- IV.2.3.1 Me kerkese te Konsumatorit, OSSH mund te zevendesojte nje mates dhe Konsumatori do te paguaj koston e nje sherbimi te tille te vleresuar nga OSSH-ja.

IV.3 Paisja e Laboratorit te Testimit te Matsave**IV.3.1 Laboratori i Matjes**

- IV.3.1.1 OSSH qe ka ose do te vendose qe te kete nje laborator matje, do te autorizohet, inspektohet dhe/ose certifikohet sipas Legjislacionit ne fuqi.

IV.3.1.2 OSSH qe nuk ka laboratore matje mund te autorizohet nga DPMK qe te kryej teste ne nje laborator te aprovuar sipas Legjislacionit ne fuqi.

IV.3.2 Paisjet e Matjes

IV.3.2.1 OSSH qe realizon sherbimin e matjes se Energjise Elektrike duhet, te kete instrumanta portabile testimi ose matesa vat –ore brenda kufijeve te pershkruar ne kete Kod, si dhe modele per te testuar sherbimin e matjes ne vat – ore, instrumentave te komutimit, matesave te frekuences, matesave te tensionit dhe instrumentave te tjere elektrik sipas Legjislacionit ne Fuqi.

IV.3.3 Testet e Matesave Standart Portabel

IV.3.3.1 Me qellim qe te testohet saktesia e matesave portabel, zakonisht te quajtur “mates standart portabel” dhe instrumentat e tjera portabel te perdorur per matesat testues, OSSH e autorizuar nga DPMK duhet te siguroje dhe te kete te gatshme si reference ose te kontrolloje standartet e instrumentave elektrik matesit e cdo paisje tjeter te sistemit te matjes sipas legjislacionit ne fuqi.

IV.3.3.2 Matesat e kontrollit do te perdoren per kontrollin ose testimin e paisjeve te matjes se energjise elektrike.

IV.4 Kerkesat per Saktesine e Matesave

IV.4.1 Axhustimi i Matesave

IV.4.1.1 Para instalimit dhe pas testit periodik ose cdo lloj testi tjeter matesat duhet te axhustohen qe te plotesojne kerkesat e meposhtme:

- i. Cdo mates qe ka nje rregjistrim jo korrekt konstant, ose qe rregjistron pa ngarkese duhet te zevendesohet ose te riparohet qe te qendroje ne sherbim.
- ii. Cdo mates qe ka nje gabim ne rregjistrim me shume se +2% ose -4% ne ngarkese te ulet, ose $\pm 2\%$ ne ngarkese te plote, duhet te zevendesohet ose mos lejohet te qendroje ne sherbim pa u axhustuar. Kurdo qofte nje mates qe kalon keto limite duhet te axhustohet.
- iii. Matesit duhet te axhustohen me gabim brenda normave te lejuara. Tolerancat jane te specifikuara vetem per variacione te nevojshme, dhe matesit nuk duhet te axhustohen per tolerancat e lejuara.

IV.5 Vendi dhe Metodat per Testimin e Matesave

IV.5.1 Te gjitha testet e matesave duhet te behen me aparatura testimi te aprovuara edhe/ose te certifikuara sipas Legjislacionit ne fuqi.

IV.6 Testet Primare te Matesave per Instalim

- IV.6.1 Te gjithë matesat e rinj do të testohen dhe rregullohen për tu rregjistruar me saktësi brenda limiteve të specifikuara në këtë Kod përpara instalimit.
- IV.6.2 Matesat do të testohen dhe rregullohen për instalimit për të rregjistruar korrekt brenda klases së saktësisë $\pm 2\%$, në 50% dhe në 100% të rrymës nominale.
- IV.6.3 Transformatorët e rrymës dhe të tensionit do të testohen për të përcaktuar raportin e tyre (koeficientin e transformacionit) dhe saktësinë. Këto teste do të bëhen nga laboratorit i autorizuar nga DPMK.

IV.7 Testet Periodike te Kontatoreve

- IV.7.1 Te gjithë tipet e matesave në pronat e klienteve duhet të testohen në përshatje me rishikimin e fundit të standarteve të IEC për matesat e Energjisë Elektrike dhe paragrafet e mesipër të këtij Kodi.
- IV.7.2 Te gjithë matesat që ndodhen në shërbim, por që mbas daljes së këtij Kodi nuk kanë një raport që të vërtetojë kryerjen e testit brenda periudhës së kohës të specifikuar për këtë kategori matesash, duhet të testohen së bashku me shpejtë që të jete e mundur.

IV.8 Testet me Kerkese te Klienteve

- IV.8.1 Cdo klient ka të drejtë të kërkojë testimin e matesit në laboratorin e OSSH-es ose në cdo laborator privat të licensuar. Ai do të paguajë koston e cdo testi në qoftë se rezultati i testit të matesit rezulton brenda klases përkatëse të saktësisë, në të kundërt shpenzimi mbulohet nga OSSH-ja, nëse testi kryhet nga një laborator i saj.
- IV.8.2 Testet që kryhen nga laboratorët privat të licensuar, në të gjitha rastet paguhen. Laboratori është i detyruar të dorëzojë zyrtarisht klientit, protokollin e plotë të testimit.
- IV.8.3 Me kërkesën e klientit, Laboratori i OSSH-es është i detyruar të dorëzojë klientit protokollin e testit për matesin e tij. Një kopje e përmbledhjes së këtij raporti mbahet në një skedar në zyrat e OSSH-es për një periudhë prej (2) dy vjetësh.

IV.9 Pasaktesite e Matjeve

- IV.9.1 Rregullimet për pasaktesitë e matjeve do të kufizohen për periudhën e fundit 12 mujore dhe do të bëhen si më poshtë:
- IV.9.2 Sa here që konstatohet nga OSSH ose subjekte të tjera të autorizuar nga Legjislacioni në fuqi, që matesi i kalon kufijtë e tij të saktësisë të përcaktuara në këtë Kod Matje (minus ose plus) atëherë do të aplikohet procedura e mëposhtme:
- i. Në rastin kur kemi rezultate të pasakta dhe gabimi i kalon kufijtë e përcaktuar në këtë Kod dhe klienti ka paguar me shumë, atëherë OSSH është i detyruar të rimbursojë vlerën tek klienti për të pakten 12 muaj. Rimbursimi do të bëhet duke korrigjuar faturat e tjera të klientit në vijim deri në kryerjen e plotë të rimbursimit,

ose ky rimbursim mund te paguhet i plote brenda 45 diteve nga evidentimi i pasaktesise se matjes (faturimit). Per menyra te tjera pagese, OSSH dhe klienti duhet te bien dakord me mareveshje midis tyre.

- ii. Ne rastin kur kemi rezultate te pasakta dhe gabimi i kalon kufijet e percaktuar ne kete Kod dhe klienti ka paguar me pak, atehere konsumatori eshte i detyruar te paguaje vleren e mbetur per te pakten 12 muaj. Pagesat do te behen duke korrektuar faturat e tjera te klientit ne vijim deri ne kryerjen e plote te pageses, ose kjo pagese mund te paguhet e plote brenda 45 diteve nga evidentimi i pasaktesise se matjes (faturimit). Per menyra te tjera pagese OSSH dhe klienti duhet te bien dakord me mareveshje.

KAPITULLI V – HYRJA NE FUQI

V.1 Ky Kod Matje hyn ne fuqi 15 dite pas publikimit ne Fletoren Zyrtare.

Shtojca A**Termat dhe Percaktimet per Kodin e Matjes ne Shqiperi**

| TERMI | PERKUFIZIMI |
|---|---|
| Kodi i Matjes Elektrike (KME) | KME percakton kerkesat teknike te ndertimit dhe shfrytezimit te sistemit te matjes elektrike, i cili do te jete i pershtatshem per matje, per mbledhjen e te dhenave zbatimin e procedurave perkatese sipas Rregullave te Tregut, Marreveshjen per Pjesemarrjen ne Treg dhe Legjislacionit ne Fuqi. |
| Çertifikimi | “Çertifikim” kuptohet veprimtaria nepermjet se ciles nje pale e trete dhe e pavarur deshmon zyrtarisht se nje produkt, proces ose sherbim eshte ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne udhezimet metodike te Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise dhe Kalibrimit ose ne Standarte. |
| Ditet e punes | Ditet e punes kupton çdo dite pervec te shtunes dhe te dieles dhe dite-feste zyrtare ne territorin e Republikes se Shqiperise. |
| Energjia Elektrike Aktive (Wh) | Energjia Elektrike eshte fuqia aktive qe gjenerohet apo kalon ne nje qark elektrik gjate nje intervali kohe, dhe percaktohet nga integrali i caktuar i fuqise aktive ne kufijte e kohes. Njesia matese e saj eshte Vat-Ore ose shumefisha te saj: 1000Wh=1kWh 1000kWh=1MWh 1000MWh=1GWh 1000GWh=1TWh=10 ¹² Wh |
| Energjia Elektrike Reaktive (VArh) | Energjia Elektrike reaktive eshte integrali i caktuar me kufije kohe i Fuqise reaktive matur ne njesi me volt-amper reaktive–ore ose shumefisha te saj. 1000 VArh = 1 kVArh 1000 kVArh = 1MVArh 1000MVArh=1GVArh 1000GVArh=1TVArh=10 ¹² VArh |
| Fuqia Elektrike Reaktive (VAr) | Fuqia Elektrike Reaktive eshte produkti i tensionit dhe rrymes dhe sinusit te kendit te fazes ndermjet tyre. $Q=(U \times I) \times \sin\phi$, matet me njesine volt–amper reaktiv(VAr) dhe shumezime standarte 1000 VAr = 1kVAr 1000 kVAr =1MVAr 1000MVAr=1GVAr 1000GVAr=1TVAr=10 ¹² VAr |
| Fuqia Elektrike Aktive (W) | Fuqia Elektrike eshte produkti i tensionit dhe rrymes dhe |

| | |
|--|--|
| | <p>kosinuset te kendit ndermjet tyre. $P=(U \times I) \times \cos\phi$</p> <p>Matet me njesine Vat (W) ose shumezime standarte :</p> <p>1000W=1kW</p> <p>1000kW=1MW</p> <p>1000MW=1GW</p> <p>1000GW=1TW=10^{12}W</p> |
| Eksport - Import | Import – Eksport quhet levizja e Fluksit te Energjise Elektrike nga impiante ose instalime elektrike te nje vendi, ne impiante ose instalime elektrike te nje vendi tjetër. |
| Perdorues | Persona qe kryejne aktivitetet te licensuara ne Sistemin elektroenergjitik si Gjenerues, OSSH, Konsumator i Kualifikuar, furnizues dhe ndonje person tjetër ligjor qe perfiton nga sherbimet e sistemit te Transmetimit. |
| Kerkesa Maksimale per Energji Elektrike | Kerkesa maksimale eshte vlera me e larte e kerkeses e rregjistruar ne nje kohe te caktuar per te percaktuar tarifat ose per qellime te tjera. |
| Mates | Kupton nje paisje per matjen dhe rregjistrimin e Energjise Elektrike. |
| Matja | Matja eshte nje seri veprimesh per te percaktuar vleren e nje sasie. |
| Autorizim | Autorizim do te thote garantimin e te drejtes per te kryer verifikime dhe kalibrime te paisjeve te matjes ne nje zone te detyrueshme te subjekteve publike ose private, te huaj ose vendas qe kryejne aktivitetin e tyre ne Republiken e Shqiperise. |
| Kalibrim | Kalibrim do te thote nje seri aktivitetesh te kryera ne kushte specifike per te percaktuar maredhenjen ndermjet vlerave te treguara nga matesi me vlerat korresponduese te treguara nga matesi etalon. |
| Pika e matjes | Pika e matjes eshte vendin fizik ku eshte realizuar pika e lidhjes dhe ku sistemi i matjes ploteson te gjitha kushtet teknike dhe te saktetise sipas ketij Kodi. Pika fizike e matjes percaktohet plotesisht nga marreveshjet midis Paleve. |
| Pika e lidhjes | Pika e lidhjes eshte vendi fizik ku realizohet lidhja e Perdoruesit/Konsumatorit me Sistemin e Trasmetimit /Sistemin e Shperndarjes. |
| Mates Kontrolli | Matesi i Kontrollit quhet matesi i autorizuar dhe i çertifikuar per kontrollin e matjes ne raste kur ka debate midis Paleve per tregimet e matjes te matesit te vendosur ne objekt, ose ne rastin e kontrolleve rutine te programuar te matesave. |
| Perputhja e matjes | Perputhja e matjes kupton krahasimin e vleres te energjise te rregjistruar ne mates me vleren e energjise totale te kerkuar (e rregjistruar ne distance). |
| Sistemi i Matjes se Energjise Elektrike | Sistemi i Matjes kupton teresine e paisjeve te matjes: matesin, automatit, transformatoret e matjes, mbrojtjen e matesit dhe izolatoret, qarqet dhe paisjet e ruajtjes te te |

| | |
|---|--|
| | dhenave, paisjet e transmetimit dhe komunikimit te te dhenave dhe lidhjet e nevojshme kablore te cilat jane pjese e paisjeve te matjeve te Energjise Elektrike aktive dhe Energjise Elektrike reaktive ne objekt. |
| Periudha e marreveshjes | Periudha e marreveshjes kupton kohen gjate te ciles permbushen vlerat kontraktuale te Energjise Elektrike sipas marreveshjes tregtare midis personave apo Paleve. Kjo periudhe eshte nje vlere e plote e kohes te kerkeses per Energji Elektrike. |
| Rryma e matjes | Rryma e matjes kupton rrymen e lejuar te matesit te perdorur me qellim matje. |
| Rregjistruesi lokal | Rregjistruesi lokal kupton nje paisje shoqeruese, rregjistruese dhe memorizuese te aparatit mates ose nje kompjuter portativ, qe mund te marre te dhenat e matjes se energjise elektrike aktive, reaktive (si dhe te dhena te tjera), ti ruaje ato dhe ti riprodhoje ne nje vend dhe ne nje kohe tjeter. |
| Sistemi i te dhenave | Sistemi i te dhenave kupton nje sistem i integruar qe mbledh dhe merr te dhenat prej paisjeve te matjes (matesit) mbi bazen e nje teknologjie te caktuar komunikimi dhe programi aplikativ. |
| Sistemi i shperndarjes | Sistemi i Sperndarjes perfshin zbarat, celsat dhe paisjet transformuese ne nenstacionet 110/35/20/10 kV, dhe te gjithë elementet nen nivelin 110 kV te zoteruara nga OSSH . |
| Sistemi i Rregjistrimit te Matesit | Sistemi i Rregjistrimit te Matesit (SRM) kupton nje sistem, i cili identifikon matesin dhe konsumatorin qe i takon dhe permban te dhenat kryesore te matesit ne perputhje me KME. |
| Komisioni i Kodit te Matjes (KKM) | Komisioni I Kodit te Matjes eshte nje komision i perbere me perfaqesues nga Pjesemarresit ne Treg. Funksionet e ketij Komisioni jane te percaktuara ne kete Kod Matje. |
| IEC | Komiteti Nderkombetar Elektroteknik |
| Inspektim | Inspektim do te thote egzaminim i produktit te matjes, sherbimit, procesit ose sistemit dhe perputhshmeria e tyre me kerkesat specifike ose kerkesat e pergjitheshme bazuar ne gjykimin profesional. |
| Verifikim | Verifikim do te thote konfirmimi nepermjet egzaminimeve dhe provave qe kerkesat specifike teknike dhe metrologjike jane permbushur. |

Shtojca B**Terma dhe perkufizime per Kodin e Rrjetit, Kodin e Shperndarjes, Kodin e Matjes dhe Rregullat e Tregut ne Shqiperi**

| Termi | Percaktimi |
|---|---|
| Sherbimet Ndhimese | Te gjitha Sherbimet e nevojeshme per Operimin e sistemit te transmetimit ose shperndarjes. Sherbimet ndihmese perfshijne: <ol style="list-style-type: none"> i. Kompesimin e energjise reaktive nga Perdoruesit per te ruajtur nivelet standarte te tensionit dhe ulur humbjet ne rrjet. ii. Rregullimin fuqi aktive frekuence si dhe rezervat e lidhur me te. iii. Kompesimi i angazhimeve dhe alokimi i kapaciteteve ne linjat e interkoneksionit. |
| Vete - Prodhues | Nje njesi qe gjeneron energji elektrike nga e cila minimumi 70% perdoret direkt vete nga prodhuesi. |
| Tregu i Balancimit | Nje treg konkurues per kerkesa dhe oferta per te siguruar energjine balancuese per balancen e sistemit ne cdo ore gjate operimit ne kohe reale. |
| Sherbimi i Balancimit | Nje sherbim i siguruar nga OST per te kompensuar disbalancat per pjesemarresit e tregut. |
| Bleres | Çdo pjesemarres i tregut qe blene energji elektrike nga pjeremarresi e tjere te tregut. |
| Ko-ogjenerim | Prodhimi i kombinuar i energjise elektrike dhe energjise termike qe sjell nje perfitim te madh krahasuar me prodhimin e ndare. |
| Lista e Kufizimeve (shkurtimeve) | Nje liste konsumatoresh, grup konsumatoresh, zona shperndarje ose OSSH te perfshira ne planin e kufizimeve. |
| Kufizim ose Reduktim i Ngarkeses | Nje procedure per te reduktuar ngarkesen qe vjen si rezultat i pamundesise se burimeve dhe aplikohet per: konsumatorin, grupin e konsumatoreve, zona shperndarje OSSH dhe /ose I gjithe sistemi elektroenergjetik. |
| Plani i Kufizimit | Nje plan i pergatitur nga OSSH per te reduktuar ngarkesen gjate pamundesive te kapacitetit per ta mbuluar ate. Plani operohet nga Qendra Dispecer. |
| Konsumator | Konsumatoret me shumice dhe ata fundor te energjise elektrike. |
| Pike Livrimi | Nje pike e sistemit elektroenergjetik e pajisur me nje ose me shume matesa ku behet livrimi i energjise elektrike ne rrjet. |

| | |
|--|---|
| Linje Direkte | Nje linje elektrike qe lidh nje prodhues te izoluar me nje konsumator te izoluar ose nje linje elektrike qe lidhe nje prodhues dhe nje furnizues te energjise elektrike direkt me godinat e tyre dhe Konsumatoret e Kualifikuar. |
| Qendra Dispecer | Nje division i OST e cila skedulon dhe dispeceron burimet e sistemit ne menyre qe te behet mbulimi I ngarkeses si dhe siguron operimin e qendrushem te sistemit elektroenergjetik. |
| Njesite Gjeneruese te Dispecerueshme | Nje njesi gjeneruese e cila mund te skedulohet ne tregun me shumice te energjise elektrike, e cila mund te jete: <ul style="list-style-type: none"> - Njesite gjeneruese hidrike te energjise elektrike te lidhura direkt me rrjetin e transmetimit - Njesite gjeneruese termik(TPPs) e te energjise elektrike te lidhura direkt me rrjetin e transmetimit - Prodhuesit e pavarur hidrike(HPPs) te energjise elektrike te lidhur direkt me rrjetin e transmetimit - Njesite gjeneruese qe gjenerojne energji elektrike per nevojat e tyre te lidhura me rrjetin e transmetimit qe mund te importojne/ eksportojne energji elektrike nga rrjeti. |
| Dispecerimi | Operimi i Sistemit Elektroenergjetik me qellim mbajtjen e balancave te gjenerimit, import/eksportit dhe konsumit te energjise elektrike ne nivelin kombetar duke garantuar sigurine e sistemit elektroenergjetik. |
| Mosmareveshje | Ne kuptimin e Rregullave te Tregut dhe te Kodeve teknike jane diferencat qe dalin ndermjet OST dhe ndonje pale tjeter per ose ne lidhje me Rregullat e Tregut dhe Kodet teknike. |
| Gjeneratoret Shperndare Kodi i Shperndarjes | e Impiantet e gjenerimit te lidhura me sistemin e shperndarjes. Nje teresi rregullash teknik te cilet menaxhojne operimin e sistemit te shperndarjes dhe vendosin kushtet dhe termat per sherbimin qe OSSH realizon per konsumatoret. |
| Operatori i Sistemit te Shperndarjes - OSSH | Nje person juridik pergjegjes per operimin, sigurine dhe mirembajtjen dhe nese eshte e nevojshme zhvillimin e sistemit te shperndarjes ne nje zone te pecaktuar dhe, nese eshte e aplikueshme interkonjekonektimin e tij me sistemet e tjera per te siguruar ne nje periudhe afat gjate aftesine e sistemit |

| | |
|--|--|
| | per te permbushutr kerkesat per shperndarjen e energjise elektrike. |
| Deklarimet Dinamike te te Dhenave | Karakteristika fizike te gjeneratoreve dhe te disa klienteve te medhenj qe informojne OST se si mund te ndryshoje prodhimi ne njesine gjeneruese perkatese ose konsumin ne njesine e ngarkeses. |
| Prioritetet Ekonomike | Renditja e burimeve qe furnizojne energjine elektrike ne perputhje me kriteret ekonomike. |
| Energji Elektrike | Do te thote energji elektrike dhe fuqi elektrike, pervec kur konteksti e kerkon ndryshe. |
| Tregu i Energjise Elektrike | Marreveshje tregtare per shitjen ose blerjen me shumice ose pakice te energjise elektrike ne sistemin elektroenergjitik per te siguruar nje furnizim te qendrueshem te konsumatoreve ne teritorin e Rrepublikes se Shqiperise. |
| Enti Rregullator i Energjise (ERE) | Institucioni rregullator qe operon sipas Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike dhe Ligjit per Sektorin e Gazit Natyror. |
| Klienti (Konsumatori) i Kualifikuar | Nje klient qe ka te drejte te zgjedhe furnizuesin e energjise elektrike per energjine elektrike qe perdor per nevojat e tij. |
| Klienti tarifor | Klienti (konsumatori) qe blen energji elektrike per perdorim vetjak. Nje perpjekje globale ose e integruar me qellim qe te ndikojte ne sasine dhe ne kohen e konsumit te energjise me qellim qe te reduktojte konsumin primar te energjise ne pikun e ngarkeses duke i dhene prioritet masave per rritjen e eficences se energjise ose mallrave te tjera te tilla si nderprerja e kontratave ose rritja e investimeve per te rritur kapacitetet gjeneruese, duke marre ne konsiderate dhe ndikimet mjedisore sigurine e furnizimit si dhe te gjita aspektet e tjera te kostove qe lidhen me te. |
| Eficensa e energjise/menaxhimi kerkeses | |
| Konsumatoret Fundor | Klienti (konsumatori) qe blen energji elektrike per perdorim vetjak. |
| Force Madhore | Nje akt ose ngjarje sociale ose natyrore qe ndodh ne vend, te tilla si termetet, rrufete, ciklonet, permbytjet, vullkanet, zjarret, luftrat, konfliktet e armatosura, veprimet ushtarake ose terroriste te cilat i ndalojne te licenuareve te kryejne detyrimet e tyre te vendosura ne licensat perkatese, ose akte te tjera te cilat jane pertej kontrollit te arsyeshem ose lindin si rezultat i |

| | |
|--|---|
| | defekteve te licenses dhe jane te pamundur per tu kapercyer nepermjet veprimeve dha aftesive perkatese te te licensuareve. |
| Njesi Gjenerimi | Nje njesi fizike per prodhimin e energjise. |
| Gjenerim | Prodhimi i energjise elektrike. |
| Llogari e Gjenerimit | Nje llogari e regjistruar ne OST nga nje gjenerues ose pale importuese interkonektuese, per qellime deklarimi ne te cilen gjeneratori matet prodhimi dhe energjia e importuar dhe rregjistrohet per cdo periudhe deklarimi. |
| Kompania e Gjenerimit | Nje person i licensuar nga ERE-ja per te kryer aktivitetet e gjenerimit te energjise. |
| Matesi i Gjeneratorit | Nje mates ne nje njesi gjeneruese qe perdoret per rregjistrimin e fluksit te energjise. |
| Regjistri i Matjes se Gjeneratorit | Nje regjister i mbajtur nga OST net e cilin cdo njesi gjenerimi (pervec autoprodhuesve dhe gjeneruesve fiks (embedded) jane te regjistruar ne Rregjistrin e Matjes se Furnizimit. |
| Gjenerues | Person juridik qe mban License per gjenerimin e energjise elektrike. |
| Kodi i Rrjetit | Nje teresi rregullash teknike qe drejton operimin e sistemit te transmetimit. |
| Nje sipermarje e integruar horizontalisht | Nje sipermarje qe kryen minimumi nje funksion si gjenerimi per shitje, ose transmetim, ose shperndarje ose furnizim me energji elektrike ose ndonje aktivitet tjeter jo ne lidhje me energjine elektrike. |
| Konsumatoret Shtepiak | Konsumatoret qe blejne energji elektrike per perdorimin e tyre shtepiak duke perjashtuar aktivitetet tregetare ose profesionale. |
| Disbalanca | Diferenca mes fluksit te energjise te percaktuar nga nje kontrate dypaleshe dhe fluksit aktual te matur te energjise per nje ore te caktuar. Nje gjenerator eshte <i>ne balance</i> kur gjenerimi i tij i matur eshte i barabarte me livrimin e kontraktuar ne nje ore te caktuar. Nje furnizues (i jashtem ose i kualifikuar/ konsumator i kualifikuar /OSSH) eshte ne balance kur energjia e tij e marre e matur perputhet me energjine e tij te marre te kontraktuar. Nje gjenerator eshte <i>ne mungese</i> kur gjenerimi i tij i matur eshte me i vogel se livrimi i tij i kontraktuar. Furnizuesi eshte ne mungese kur energjia e tij e marre e matur eshte me e madhe se energjia e tij e marre e kontraktuar. Nje gjenerator eshte ne teprice kur gjenerimi i tij i matur eshte me i madh se livrimi i tij i kontraktuar. |

| | | |
|---|----|--|
| | | Nje furnizues (i jashtem ose i kualifikuar/ konsumator i kualifikuar /OSSH) eshte ne teprice kur energjia e tij e marre e matur eshte me e vogel se energjia e tij e marre e kontraktuar |
| Sipermarje e Integruar e Energjise Elektrike | | Nje sipermarje e integruar vertikalisht. |
| Sisteme Interkonjektuara | te | Nje numer sistemesh transmetimi she shperndarje te lidhura se bashku nepermjet nje ose me shume interkonjektoreve. |
| Interkoneksion | | Nje linje transmetimi e percaktuar me te cilen energjia elektrike mund te tregetohet me palet e tjera jashte dominimit te OST. |
| Interkonjektor | | Nje paisje qe perdoret per lidhjen e sistemeve elektrike. |
| IPP – Prodhues i Pavarur i Energjise Elektrike | | Nje gjenerues i lidhur me sistemin e transmetimit. Te gjithe prodhuesit (gjeneruesit) ne Shqiperi pervec Kompanise se Gjenerimit Publik jane IPP. |
| KESH | | Korporata Elektroenergjitike Shqiptare |
| KESH Gjen | | Divizioni i KESH i licensuar per prodhimin e energjise elektrike. KESH – Gjen ne fillim do te jete Gjenerues dhe Furnizues Publik. |
| License | | Nje autorizim i dhene per nje person bazuar ne pjesen e trete te Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike. |
| I Licensuari | | Nje person qe mban nje license bazuar pjesen e trete te Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike. |
| Planifikimi Afat -gjate | | Planifikimi i nevojës për investime në gjenerim, transmetim dhe shpërndarje në periudha afat gjatë, me qëllimin e plotësimit të kërkesës së sistemit për energji elektrike dhe për të siguruar furnizimin e konsumatoreve. |
| Mareveshje Pjesemarrjes ne Treg | e | Dokument i firmosur nga të gjitha palët të cilet pranojnë të binden Rregullave të Tregut. |
| Rregullat e Tregut | | Rregullat që rregullojnë operimin dhe menaxhimin e tregut, si dhe mërdheniet tregëtare ndërmjet të Licensuarëve ose paleve të tjera që kanë firmosur Mareveshjen e Pjesemarrjes në Treg. |
| Konsumator jo-shtëpiak | | |

| | |
|--|--|
| Off-take | Cdo person juridik qe blen energji elektrike te cilen nuk e perdor per konsum shtepiak dhe do te perfshije prodhuesit dhe konsumatorët me shumice. Lidhet me energjine e marre nga rrjeti i transmetimit ose shperndarjes |
| OST | Operatori i Sistemit te Transmetimit me tre funksione: Operator i Tregut te energjise elektrike, Operator i Sistemit te Transmetimit, Operator i Dispecerimit te Sistemit. |
| Pjesemarres | Nje Person juridik i licensuar ose i autorizuar nga ERE per te marre pjese ne tregun e Energjise Elektike ne Shqiperi me funksione te specifikuara. |
| Pale Person | Nje firmoses i mareveshjes per pjesemarrje ne treg. Nje person fizik ose juridik. |
| Nominim Fizik | Eshte njoftimi i bere ne OST nga nje pale tregetuese ku jane specifikuar MW qe do te shperndahen ose do te merren ne nje dite specifike. |
| Gjenerimi i Energjise Elektrike | Prodhimi i energjise elektrike nepermjet transformimit te burimeve te ndryshme te energjise nga nje Kompani Gjenerimi. |
| Ligji per Sektorin e Energjise Elektrike | Ligji Nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike” sic mund te jete amenduar here pas here. |
| Sistemi i Energjise Elektrike | Nje sistem i interkonjektuar qe perbehet nga centrale elektrike, linja, nenstacione dhe pajisje shperndarje, me synim transmetimin ose shperndarjen e energjise elektrike tek klientet. |
| Prodhues | Person juridik qe gjeneron Energji Elektrike. |
| Kompania Publike e Gjenerimit | Nje person i licensuar nga ERE-ja per te kryer aktivitetet e gjenerimit te energjise, per sa koh kjo kompani nuk eshte vendosur, ky funksion kryhet ne KESH nga Divizioni i Prodhimit. |
| Furnizuesi i Kualifikuar | Nje person i licensuar per te funizuar energji elektrike direkt tek Klientet e Kualifikuar. |
| Burime Rigjenerueshme Energjise Elektrike | Burime te rigjenerueshme jo fosile te energjise (era, dielli, gjeotermal, valet, hidroenergja, baticat, plehrat, biomasa, gazi, trajtimi i ujrave te zeza nepermjet impianteve te gazit ose biogazit). |
| Furnizusi Publik me | |

Pakice

Furnizuesi i licensuar per te furnizuar me energji elektrike konsumatoret tarifore. Nese Licensa e furnizimit publik me pakice mbahet nga nje kompani per Shperndarjen e energjise elektrike, do te kete nje ndarje strukturore dhe financiare te funksioneve te furnizimit nga ato te shperndarjes.

| | |
|---|---|
| Periudha e programuar e dispecerimit | Periudha me e shkurter per te cilen Qendra Dispecer kryen dhe publikon nje program te planifikuar dispecerimi te bazuar ne ngarkesa te planifikuara elektrike dhe oferta aktuale dhe programin qe drejtohet nga pjesmarresit per burimet. |
| Siguria | Perfshin te dyja sigurine e furnizimit me energji elektrike si dhe sigurine teknike. |
| SEE | Sistemi Elektroenergjitik |
| Shites | Cdo pjesmarres tregu, qe shesin energji elektrike tek pjesmarresit e tjere te tregut. |
| Periudhe Deklarimi | Nje periudhe nje oreshe qe fillon ne oren ne te cilen fillon livrimi i energjise dhe matjet e energjise se livruar jane kryer. |
| SPP – Prodhues i Vogel i Energjise | Nje gjenerues i lidhur me rrjetin e shperndarjes me nje kapacitet me te vogel se 5 MW. |
| Parametrat Standart | Vlera e nivelit te tensionit dhe frekuences ne energjine e furnizuar tek konsumatoret sic eshte percaktuar ne rregulloret e operimit te Sistemit elektroenergjitik te aprovuara nga ERE. |
| Furnizim | Shitja, duke perfshire dhe rishitjen e energjise elektrike tek konsumatoret. |
| Perdoruesit e Sistemit | Cdo person juridik dhe fizik qe furnizon, ose furnizohet nga sistemi i Transmetimit ose i Shperndarjes. |
| Konsumator Tarifor | Konsumatori i furnizuar nga Furnizuesi Publik me Pakice me cmime dhe tarifa te rregulluara nga ERE. |
| Procedure Tenderimi | Procedura nepermjet te ciles kerkesa te planifikuara shtese dhe zevendesime te kapacitetit jane te mbuluara nga furnizuesit nga kapacitetet e reja ose ato egzistuese te gjenerimit. |

| | |
|--|---|
| Akses i Paleve te Treta | E drejta ligjore e konsumatoreve dhe furnizueseve te kualifikuar per te perdorur Sistemin e transmetimit ose te shperndarjes. |
| Tregetar | Pala qe ka firmosur Marreveshjen per Pjesemarrje ne Tregun e energjise elektrike me qellim tregetimin e energjise elektrike. |
| Transmetim | Eshte transporti i energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte ose ne cdo instalim tjeter, pavaresisht nga tensioni, funksionet e te cileve perfshijne transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar. |
| Sistem Transmetimi | Nje sistem linjash, strukturash mbeshtetese, pajisjesh transformuese dhe kycese qe perdoren per transmetimin e energjise elektrike. |
| Operator i Sistemit te Transmetimit | Nje person juridik pergjegjes per te siguruar mirembajtjen, operimin, dhe nese eshte e nevojeshme zhvillimin e sistemit te transmetimit ne nje zone te dhene, si dhe te interkoneksioneve me sistemet e tjera, dhe per te siguruar ne periudha afat gjata aftesine e sistemit per te transmetuar energji elektrike per te plotesuar kerkesen. |
| UCTE | Unioni per Koordinimin e Transmetimit te Energjise Elektrike, nje organizate Europiane Operatoreve te Sistemit te Transnetimit qe garanton sigurine e shkembimeve ndermjet rrjeteve. |
| Konsumator me Shumice | Cdo person fizik ose juridik i cili blen energji elektrike me qellim realizimin, rishitjen Brenda ose jashte sistemit aty ku ata jane vendosur. |
| Furnizuesi Publik me Shumice | Do te thote nje njesi qe blen energji elektrike te kerkuar per te furnizuar konsumatoret tarifore dha kete energji |

ky furnizues ia shet Furnizuesit Publik me Pakice.